



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Politikë për Makroprudencë

P R I S H T I N Ë , Q E R S H O R 2 0 1 8



Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.3 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi Ekzekutiv në takimin e mbajtur më 10 gusht 2016 miratoj si në vijim:

## **Politikë për Makroprudencë**

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i Politikës së Makroprudencës është identifikimi, monitorimi dhe vlerësimi i rreziqeve sistematike për stabilitetin financiar, me qëllim të mbrojtjes së stabilitetit të sistemit financiar si tërësi. Rreziku sistematik i përmban në vete dy dimensione ciklike që i referohen shpërndarjes së rreziqeve me kohë, si dhe dimensionin strukturor që i referohet shpërndarjes së rreziqeve nëpër sistemin financiar në çdo moment të caktuar kohor. Politika e Makroprudencës synon të minimizojë çrregullimet në ofrimin e shërbimeve financiare duke reduktuar çekuilibrimet financiare dhe rreziqet eventuale. Këtë do ta arrijë duke përdorur masa që kufizojnë shpejtësinë dhe shtrirjen e efekteve të pafavorshme ekonomike, dhe duke identifikuar ekspozimet eventuale, koncentrimet e rrezikut, lidhjet dhe ndërvarësitë që mund të jenë burim i shpërndarjes. Gjithashtu, do të adresojë rreziqet e përhapjes eventuale që mund të jenë të dëmshme për funksionimin e sistemit si tërësi.

Kriza financiare globale ka treguar se si jo-stabiliteti në sistemin financiar rezulton në çrregullime të konsiderueshme ekonomike, duke vënë presion të konsiderueshëm financiar mbi ekonomitë familjare dhe bizneset, si dhe presion të konsiderueshëm mbi bilancet e qeverisë. Rrjedhimisht është arritur konsensus ndërkombëtar që korniza rregullative e përqendruar kryesisht në stabilitetin e institucioneve financiare individuale nuk është e mjaftueshme për menaxhimin e rreziqeve mbi sistemin financiar si tërësi. Politika për Makroprudencë mbështetet në kornizën ekzistues rregullative për të promovuar stabilitetin e sistemit financiar si tërësi.

Me qëllimet të implementimit të Politikës së Makroprudencës, Bordi Ekzekutiv si organ vendimmarrës do të mbështetet nga Komiteti Këshillëdhënës i Makroprudencës (KKMP) në shqyrtimin dhe rekomandimin e një game të tërë të politikave.

### **Neni 2 Objektivat e Politikës së Makroprudencës**

Objektivi kryesor i Politikës së Makroprudencës është të ndihmojë në ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar të Kosovës si tërësi. Këtë do ta bëjë në rend të parë duke fuqizuar rezistencën e sistemit financiar dhe duke zvogëluar akumulimin e rrezikut sistematik, për të siguruar kështu sektor financiar të shëndoshë që kontribuon në rritje ekonomike të qëndrueshme. Rreziku sistematik do të thotë rreziku i çrregullimeve të përhapura në ofrimin e shërbimeve financiare që kanë pasoja negative për ekonominë në përgjithësi.

Objektivat e ndërmjetme të Politikës së Makroprudencës, që ndihmojnë në operacionalizimin e objektivit kryesor dhe sigurojnë rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, janë miratuar si më poshtë<sup>1</sup>:

- (a) Zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe të levës;
- (b) Zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar të maturitetit;
- (c) Zvogëlimi dhe parandalimi i jo-likuiditetit
- (d) Kufizimi i direkt dhe indirekt i koncentrimit të ekspozimeve kreditore;
- (e) Kufizimi i ndikimit sistemik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral;
- (f) Forcimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës financiare.

### **Neni 3 Fushëveprimi dhe zbatimi i politikës së Makroprudencës**

Fushëveprimi i Politikës së Makroprudencës është sistemi financiar si tërësi. Megjithatë, çështjet e Politikës së Makroprudencës të BQK-së në nivel nacional janë përbrenda kornizës së Bordit Evropian për Rrezik Sistemik, me specifika që ndërlidhen me karakteristikat nacionale, në veçanti strukturimi i objektivave të ndërmjetme, që tani për tani janë të përqendruara kryesisht në sektorin bankar.

Fushëveprimi i kësaj politike orienton përpjekjet e BQK-së si më poshtë:

- i) Masat për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve të sistemit financiar të Kosovës në baza të rregullta;
- ii) Masat për identifikimin e hershëm të akumulimit të rreziqeve të sistemit financiar dhe të presioneve me qëllim që t'iu mundësohet autoriteteve ndërmarrja e veprimeve në një fazë të hershme për të parandaluar zhvillimin e krizës apo për të zvogëluar efektin e saj;
- iii) Masat për identifikimin, kuptimin dhe menaxhimin lidhjeve dhe ndër-lidhjeve brenda sistemit financiar të Kosovës dhe ato ndërmjet sistemit financiar dhe ekonomisë reale në Kosovë, që mund të përkeqësojnë ndjeshmërinë e sistemit financiar të Kosovës ndaj goditjeve;
- iv) Masat për reduktimin e shkallës së rrezikut përbrenda sektorit financiar të Kosovës me qëllim të reduktimit të probabilitetit për shfaqje të krizës financiare në të ardhmen;

### **Neni 4 Instrumentet e Politikës së Makroprudencës**

Për të përmbushur mandatin e Politikës së Makroprudencës dhe për të rritur rezistencën e sistemit financiar, KKMP do të këshillojë Bordin Ekzekutiv të BQK-së rreth aplikimit të instrumenteve të përshtatshme të Makroprudencës.

Instrumentet e Makroprudencës do të shfrytëzohen ashtu si mandatohet nga kompetencat ligjore të BQK-së. Secili prej instrumenteve shfrytëzohet me një qasje të ndërlidhshmërisë për arritjen e një apo më tepër objektivave të ndërmjetme. Megjithatë, BQK-ja mund të vendosë për aplikimin e më shumë instrumenteve. Instrumentet që përdoren nga BQK-ja kanë qëllim preventiv duke vendosur limite në nivelin dhe llojet e rreziqeve që mund të ndërmerren nga institucionet financiare, me qëllim të zvogëlimin

---

<sup>1</sup> Bordi Evropian për Rrezik Sistemik (ang. European System Risk Board) ka miratuar Rekomandimet BERS (2014a) dhe BERS (2014b) që kanë të bëjnë me qëllimin dhe objektivat e implementimit të Kornizës për Makroprudencë.

të probabilitetit dhe shtrirjes së një krize financiare në të ardhmen. Në këtë kontekst, shumë nga instrumentet rregullative që BQK-ja tanimë i ka në përdorim kanë njëkohësisht edhe efekte të Makroprudencës.

Lista në vijim përcakton gjithashtu kompetencat aktuale ligjore të BQK-së lidhur me secilin instrument potencial dhe aranzhimin e çdo instrumenti nëse ai tanimë është në shfrytëzim. Lista e instrumenteve që ndërlidhen me objektivat e ndërmjetme të Politikës Makroprudencës së BQK-së është elaboruar në Shtojcën I. të kësaj Politikeje.

Lista e instrumenteve përfshin por nuk kufizohet në instrumentet si në vijim:

### **Autoriteti ligjor i instrumentit**

1.	Kapitali minimal rregullativ,	Neni 16, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
2.	Kapitali rregullativ shtesë,	Neni 16, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
3.	Kërkesa shtesë mbi kapitalin e kërkuar	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
4.	Rezervat minimale,	Neni 12, Ligji për BQK-në
5.	Kërkesat për likuiditet,	Neni 19, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
6.	Limitet agregate të kreditimit,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
7.	Limitet e kreditimit për sektorët specifik,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
8.	Kufizimet në ekspozimet e mëdha,	Neni 46, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
9.	Limitet e kreditimit për personat e ndërlidhur,	Neni 47, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
10.	Limitet në raportin kredi/vlerë,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
11.	Raportet kredi/të ardhurat e kredimarrësit,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
12.	Shkalla e levës,	Neni 16, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
13.	Kapaku i kredive ndaj depozitave,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
14.	Limitet në ekspozimet e mëdha mbi financimin,	Neni 46, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
15.	Limitet në financimin e jashtëm,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
16.	Limitet në financimin me shumicë të tregut,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
17.	Limitet për ekspozimet e valutës së huaj,	Neni 50, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-te
18.	Limitet mbi mospërputhjet e maturimit,	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
19.	Limitet në pagesat e dividendëve,	Neni 58, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
20.	Limitet për shpërblimet,	Neni 58, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
21.	Shpalosja e zgjëruar,	Neni 56, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të

## **Neni 5 Qeverisja**

Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës nr. 03 / L-209, Bordi Ekzekutiv ka themeluar KKMP-në. Termat e referencës mbi themelimin e KKPM-së rregullojnë detyrat, objektin e punës, kërkesat rreth raportimit dhe procesin e vendimmarrjes. Termat e referencës së KKMP-së janë pjesë përbërëse e politikës së Makroprudencës (Shih Shtojcën III).

## **Neni 6 Transparenca dhe Llogaridhënia**

Bordi Ekzekutiv i BQK-së siguron që vendimet për politiken e Makroprudencës dhe zbatimin e tyre bëhen publike në kohën e duhur, përveç nëse publikimi i tyre shkaktohen rreziqe për stabilitetin financiar.

## **Neni 7 Shtojcat**

Pjesë përbërëse të kësaj Politike janë:

Shtojca I - Objektivat e ndërmjetme dhe instrumentet e makroprudencës,

Shtojca II- Indikatorët e makroprudencës të monitoruar nga BQK-ja ndërlidhur me objektivat e ndërmjetme

Shtojca III – Termat e referencës për Komitetin Këshillëdhënës të Makroprudencës

## **Neni 8 Hyrja në fuqi**

Kjo politikë hynë në fuqi nga data e miratimit.

## Shtojca I- Objektivat e Ndërmjetme dhe Instrumentet e Makroprudencës

### I. Objektivat e ndërmjetme

Autoritetet që ushtrojnë funksionin e makroprudencës u rekomandohet të ndjekin objektivat e ndërmjetme me qëllim të arritjes së objektivit përfundimtar të politikës së makroprudencës - një sistem i qëndrueshëm dhe elastik financiar. Sipas rekomandimit të Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (BERS) të 4 prillit 2013 për Objektivat e Ndërmjetme dhe Instrumentet e Politikës së Makroprudencës (BERS/2013/1), identifikimi dhe përcaktimi i objektivave të ndërmjetme është vendimtar, pasi që ato e bëjnë politikën e Makroprudencës më funksionale, transparente, të përgjegjshme dhe paraqesin një bazë për zgjedhjen e instrumenteve në dispozicion. BQK-ja, në përputhje me Rekomandimin e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik për Mandatin e Makroprudencës të Autoriteteve Kombëtare (BERS/2011/3) ka adaptuar këto objektiva të ndërmjetme, që pasqyrojnë zhvillimet e sektorit financiar të Kosovës dhe infrastrukturën:

- a) Zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe të levës;
- (b) Zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar të maturitetit;
- (c) Zvogëlimi dhe parandalimi i jo-likuiditetit;
- (d) Kufizimi i direkt dhe indirekt i koncentrimin të ekspozimeve kreditore;
- (e) Kufizimi i ndikimit sistemik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral;
- (f) Forcimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës financiare.

a) **Objektivi i parë i ndërmjetëm** përfshin zbutjen dhe parandalimin e rritjes së tepërt të kredive që është identifikuar si një komponent kyç i krizës financiare në mbarë botën. Bankat kanë dhënë kredi edhe për pronat financiare të përfshira në bashkimet dhe blerjet, si dhe blerjet tepër të liferuara të aksioneve nga menaxhmenti. Marrja endogjene e rrezikut të sektorit bankar gjatë një periudhe të bumit para krizës së bashku me standardet në rënie të kreditimit ka qenë fajtori numër një për krizën e fundit. Në shumë vende, nënvlerësimi i rrezikut, si dhe mundësitë e reja të gjetura në treg që shfaqen para recesionit, kanë zvogëluar standardet e kreditimit. Rritja e levës ka shtuar më tej krizën pasi që ajo ka vepruar si një kanal përforcues. Kriza ka rezultuar në një krizë të rëndë të kreditimit me pasoja të shtrëngimit të standardeve të kredisë dhe uljen e mundësisë për kredi sidomos në sektorin jofinanciar, që ka përkeqësuar edhe me tej sektorin real. Kosova në masë të madhe i ka shmangur këto rreziqe dhe zhvillime gjatë krizës së fundit financiare. Megjithatë, rreziqet ende ekzistojnë dhe BQK-ja ka nevojë të vendosë sa herë që është e mundur masat që do t'i zvogëlojnë dhe kufizojnë rreziqet e kreditimit. BQK-ja gjithashtu duhet të monitorojë nivelet e procesit të krijimit të kredive dhe të rritjes së kredive në Kosovë nga afër në mënyrë që zhvillimet negative eventuale të identifikohen në një fazë të hershme.

b) **Objektivi i dytë ka të bëjë me mospërputhjet e maturimit**, që është definuar si dallimi në mes të maturimit të mjeteve dhe detyrimeve të bankës. Rreziku për një bankë është më i madh, ku profili i maturimit të mjeteve të bankës, sikur që janë kreditë është shumë më i gjatë se sa profili i maturimit të depozitave të tyre. Në qoftë se depozitat nisin të tërhiqen, banka mund të mos jetë në gjendje t'i kthejë mjetet e saj në të holla në mënyrë të shpejtë, që do të çojë në probleme të likuiditetit, ose mund të mos jetë në gjendje t'i kthejë ato në të holla me një çmim të ulët, që do të çojë në probleme të aftësisë paguese. Sistemi bankar i Kosovës aktualisht është i varur nga financimi afatshkurtër, që mund të shfaqë një rënie të papritur pas shpërthimit të një krize të mundshme. Aktualisht, bankat e Kosovës

mbështeten kryesisht në depozitat me pakicë, të cilat kanë tendencë të jenë më të qëndrueshme se depozitat me shumicë. Gjithashtu, nuk ka dallime të mëdha në mes të strukturës së financimit të bankave në pronësi vendore dhe bankave me pronësi kryesisht të jashtme. BQK-ja do të mund të shqyrtojë mundësinë e vënies së kufizimeve të mëtejshme në mospërputhjet e maturimit dhe në llojet më të rrezikshme të financimit të tilla si depozitat e huaja dhe ato me shumicë, për të siguruar që llojet e rreziqeve të cilat kanë çuar në probleme në vende të tjera nuk do të bëhen të rëndësishme në Kosovë.

- c) **Objektivi i tretë ka të bëjë me shmangien e problemeve të likuiditetit.** Bankat duhet të mbajnë mjete likuide të tilla si para të gatshme dhe mjete, që mundën shpejt dhe me lehtësi të konvertohen në të para të gatshme për të qenë në gjendje të përmbushin kërkesat e depozituesve për tërheqje. Problemet e likuiditetit mund të lindin ose për shkak se një bankë mban mjete të pamjaftueshme likuide ose për shkak se disa nga mjetet që konsiderohen si likuide nuk mund të konvertohen shpejt në të holla të gatshme për shkak të kushteve të tregut. BQK-ja ka bërë tanimë shumë punë për këtë çështje dhe sektori bankar në Kosovë aktualisht është shumë likuid. BQK-ja ka vendosur kushte rreth likuiditetit për bankat, ka krijuar një metodologji të detajuar për analizimin e burimeve të likuiditetit të bankave dhe nevojat e tyre, si dhe ka futur në përdorim Instrumentin e Asistencës Emergjente të Likuiditetit për bankat e Kosovës.
- d) **Objektivi i katërt mbulon** ekspozimin e drejtpërdrejtë që buron nga rreziku i përqendrimit dhe ekspozimi i tërthortë që e ka origjinën nga ndërlidhshmëria e sektorit jofinanciar dhe atij financiar. Rreziqet e përqendrimit mund të lindin në të dy anët, si në aktivin ashtu edhe në anën e bilancit të bankës. Kriza e fundit financiare nuk ka zbuluar nivele të larta të përqendrimit në ekonominë kosovare, e cila është e varur në sektorë shumë të veçantë dhe të ndërlidhura fort në aspekt të pronësisë. Megjithatë, sektori i ndërtimit mund të goditet gjatë një recesioni duke shkaktuar sfida financiare për disa kompani, si dhe pasoja sa i përket rritjes së papunësisë.
- e) **Objektivi i pestë** i politikës të makroprudencës është **kufizimi i ndikimit sistemik** të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral. Pasi që nuk gjithherë e mundur të parandalohen krizat, është e rëndësishme të forcohen institucionet me rëndësi sistemike pasi që mospërmbushja e detyrimeve nga ana e tyre do të çonte në rënien e të gjithë sistemit. Perspektiva "shumë e madhe për të dështuar" e institucioneve vitale është një komponent i rrezikut sistemik që duhet të parandalohet ex ante. Duke përforcuar institucionet kryesore financiare, si dhe duke kufizuar lojtarët më miqësorë ndaj rrezikut është e mundur të zvogëlohen efektet negative të një garancie të nënkuptuar të qeverisë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i rrezikut moral është i lidhur me shpërblimin e menaxhmentit dhe mospërputhjes në mes të qëllimeve afatgjata dhe afatshkurtra. Mungesa e shfaqjes publike dhe transparencës, si dhe paqëndrueshmëria potenciale politike dhe korrupsioni janë rreziqe të mundshme për objektivin. Në varësi të natyrës së rreziqeve, politikat e tjera duhet t'i mbështesin politikat të makroprudencës në arritjen e këtij objektivi të ndërmjetëm. Kosova ka një shkallë të lartë të përqendrimit në sistemin e saj bankar prandaj disa nga bankat e saj kanë rëndësi sistemike. Kjo është e pashmangshme në një ekonomi të vogël. Është e rëndësishme që asnjë bankë e vetme të bëhet dominuese. Ajo gjithashtu duhet të jetë në gjendje të sigurojë që në qoftë se një bankë me kapital të huaj ka rëndësi sistemike në Kosovë, filiali i Kosovës të mund të izolohet nga problemet që lindin në bankat e saj amë apo diku tjetër jashtë Kosovës.
- f) **Objektivi i gjashtë i ndërmjetëm** është **forcimi i qëndrueshmërisë së tërë sistemit financiar**, duke përfshirë infrastrukturën e saj. Autoritetet të makroprudencës duhet të bashkëpunojnë me departamentet përgjegjëse të mbikëqyrjes së infrastrukturës. Ky hap është i rëndësishëm në arritjen e stabilitetit të të gjithë ndërmjetësve financiarë, si dhe në arritjen e një klime të favorshme ekonomike që rezulton në rritje ekonomike dhe stabilitet. Ndër të tjera, infrastruktura financiare kosovare përmban sisteme jetike të pagesave dhe marrëveshjeve dhe regjistrin e kredive. Në rast të një çrregullimi të rëndë në sektorin bankar, skema e garancisë së depozitave mund të aktivizohet.



Dështimi i pjesëve të përshkruara të infrastrukturës financiare mund të rrezikojë jo vetëm funksionimin e të gjithë sektorit bankar, por të gjithë ekonomisë. Avancimi i teknologjisë si dhe rritja e shërbimeve bankare online dhe shërbimeve të tjera të lidhura me internet ka prezantuar një formë të re të rrezikut - rrezikun kibernetik. Për shkak të shfaqjes së krimit kibernetik, qëndrueshmëria e sigurisë kibernetike është me rëndësi kyçe për mbështetjen e infrastrukturës.

Pozicioni i përgjithshme i sektorit financiar në një ekonomi mund të duket i shëndoshë dhe i qëndrueshëm, por kjo nganjëherë mund t'i maskojë disbalancimet e konsiderueshme në bilancet dhe shëndetin financiar të sektorëve të veçantë të ekonomisë, si industria, banimi apo bujqësia. Në qoftë se pabarazitë në cilindo sektor që është ekonomikisht i rëndësishëm në vend bëhen ekstreme, ato mund të gjenerojnë probleme të Makroprudencës për sektorin financiar të vendit dhe në këtë mënyrë për të gjithë vendin. KKMP do të përcaktojë se cilët sektorë të Kosovës janë të rëndësishëm mjaftueshëm për të paraqitur kërcënime të natyrës së Makroprudencës dhe do të analizojnë gjendjen financiare të këtyre sektorëve në mënyrë të rregullt.

Për të ndjekur objektivat e ndërmjetëm të politikës së makroprudencës, BQK-ja do të bazohet në vlerësimin e rreziqeve të vërejtura në sistemin financiar, do të përdorë instrumentet e përfshira në legjislacionin kombëtar dhe instrumente të tjera në përputhje me legjislacionin e BQK-së. Lista e instrumenteve (të mundshme) të makroprudencës është përshtatur plotësisht me objektivat e ndërmjetme të politikës së makroprudencës të BQK-së dhe është paraqitur në Tabelën 1, së bashku me bazën ligjore për përdorim e tyre.

## **II. Instrumentet, përkufizimi dhe aplikimi i tyre**

**Kërkesa rreth rezervës së likuiditetit** përfshin BQK-në dhe kërkesat për bankat për të mbajtur një pjesë minimale të depozitave të tyre si rezerva në një llogari depozite në BQK, ose në ndonjë formë tjetër siç është specifikuar nga BQK-ja. Duke ndryshuar nivelin e rezervës së detyrueshme, BQK-ja mund të ndikojnë në nivelin e fondeve që bankat kanë në dispozicion për kreditim. Kjo nga ana tjetër do të duhej të ndikojë në nivelin e normave të interesit. Ndërsa kërkesat e rezervës përdoren kryesisht si një instrument i kontrollit të kredive, ato mund të përdoren edhe si një instrument për të ndikuar në likuiditetin në dispozicion për bankat duke ulur nivelin e rezervës së detyrueshme në periudhat e presionit të likuiditetit.

**Kufizimet totale (agreguara) të kreditimit** i lejojnë BQK-së të vendosë kufizime mbi shumën totale të kredive të një banke, zakonisht për të ngadalësuar një normë të rritjes së kreditimit që konsiderohet të jetë e tepruar.

**Kufizimet e kreditimit për sektorë të veçantë** i lejojnë BQK-ja të vendosë kufizime mbi kreditë bankare në sektor(ë) specifik, kur ai sektor konsiderohet të jetë veçanërisht i rrezikshëm.

**Kërkesat kundër-ciklike të kapitalit (KCK)** lejojnë aplikimin e kërkesave të tjera të kapitalit në një mënyrë kundër-ciklike. Kërkesat për KCK mund të rriten gjatë periudhave të rritjes së përsheptuar ekonomike në përpjekje për të frenuar të ciklit e ekzagjeruar të rritjes së kredisë dhe mund të reduktohet kur cikli i kreditit ndryshon më qëllim të rritjes së aftësisë së bankave për të dhënë kredi. Kriteri kryesor për përcaktimin e normës së KCK-së do të jetë boshllëku kredi ndaj bruto produktit vendor (BPV) në Kosovë, por treguesit e tjerë relevantë do të merren parasysh gjithashtu.

**Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit** mund të përdoret duke vendosur kërkesa shtesë për shumën minimale të kapitalit që duhet mbajtur nga banka në raport me mjetet apo depozitat e saj. Instrumenti mund të specifikojë gjithashtu llojet e pasurive të pranueshme që një bankë mund të mbajë për të përmbushur kërkesat e kapitalit me një theks të veçantë në ato mjete me vlerë të fortë të kapitalit dhe karakteristika të likuiditetit në situata të krizës.

**Raporti kredi - vlerë (KV)** vendos një limit në kredinë maksimale që një bankë mund ta japë si një përqindje mbi vlerën e kolateralit të lënë peng, të tilla si pasuri të patundshme banesore. Një raport më i KV do të duhej të zvogëlojë amplitudën e ciklit të kredisë, të kufizojë fuqinë e fluskave në çmimet e mjeteve dhe të përmirësojë elasticitetin e sistemit bankar pasi që do të duhej të ulte mospagimin e kredive.

**Raporti ndërmjet kredisë dhe të ardhurave të huamarrësit (KA)** përcakton një kufi mbi barrën maksimale të shlyerjes së kredisë që mund të vendoset mbi një huamarrës, si pjesë e të ardhurave të huamarrësit. Një kufi më i ulët i KA-së LTI do të duhej të zvogëlojë probabilitetin e moskthimit të kredisë duke reduktuar kështu rrezikun në sistemin bankar.

**Raporti kredi – depozita (KD)** i përcaktuar si raporti maksimal i kërkuar KD mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Në këtë të fundit, është e përshtatshme për menaxhimin e rreziqeve ciklike. Objektivi i tij është të parandalojë mbështetjen e tepruar në financimin afatshkurtër me shumicë, e cila çon në rritjen e tepërt të kreditit dhe të liferimit. Mund të kontribuojë në përmirësimin e situatës së likuiditetit të bankave.

**Mospërputhja e maturimit** ndodh kur një institucion financiar financon mjetet afatmesme dhe afatgjata, sikur që janë kreditë apo letrat me vlerë, me depozitave afatshkurtra. Transformimi i maturimit (zgjerimin i maturimit të mjeteve financiare) është diçka që bankat e bëjnë si pjesë e operacioneve të tyre normale. Por kjo në vete përfshin rreziqe. Në një krizë, banka mund të mos jetë në gjendje të mbledh fonde të reja afatshkurtra ose të shesë mjetet afatgjata dhe afatmesme aq shpejtë sa të përmbushë rrjedhjet e depozitave afatshkurtra. Rregulloret e mospërputhjes së maturimit vendosin kufij të sipërm në sasinë dhe shkallën e mospërputhjes së maturimit që mund ta ketë një institucion financiar në pika të ndryshme përgjatë lakores së maturimit.

**Raportet e likuiditetit** janë një instrument që vendos një kërkesë për institucionet financiare për të mbajtur të paktën një pjesë të caktuar minimale të depozitave të tyre në formën e mjeteve likuide. Sa më likuide të jetë një bankë, aq më e madhe është aftësia e saj për të përballuar goditjet. Por ka një kompromis për autoritetet pasi që sa më e lartë të jetë kërkesa për likuiditet, aq më pak fonde bankat do të kenë në dispozicion për kreditim dhe ka të ngjarë që norma e interesit të kreditimit të jetë më e lartë. Vënia e kërkesave shtesë për likuiditet sikur që është ngushtimi i gamës së mjeteve që mund të mbajë një bankë për të përmbushur kërkesat e likuiditetit, pasi që disa mjete mund të perceptohen të jenë më likuide në situata krize.

**Asistenca emergjente për likuiditet** është një instrument i likuiditetit i cili është pjesërisht i financuar nga Qeveria e Kosovës dhe BQK-ja. Kërkesat për ndihmë duhet të bëhen nga një bankë komerciale që ka probleme të likuiditetit. Megjithatë është Bordi Ekzekutiv i BQK-së që vendos nëse ndihma e likuiditetit emergjent duhet të jepet. Në një situatë krize, Banka Qendrore mund të ndikojë në likuiditetin e sistemit bankar duke e zgjeruar gamën e mjeteve që do të blejë apo pranojë si kolateral. Domethënë, ata e kanë fuqinë për të shndërruar llojet e tjera të mjeteve në mjete likuide për bankat. Ato mund të sigurojnë gjithashtu likuiditet shtesë për sektorin financiar me anë të kreditimit të drejtpërdrejtë. Ligji për BQK-në kërkon që kreditimi i tillë të bazohet në "kolateral të mjaftueshëm" prandaj instrumenti kryesor i politikës për BQK-në është gama e mjeteve që do t'i pranojë si kolateral për një kredi për një institucion financiar.

**Kufizimet e ekspozimeve të mëdha** janë vënie e kufizimeve mbi sasinë e kreditimit që një bankë mund ta bëjë për një huamarrës të vetëm ose një "grup" të huamarrësve të ndërlidhur. Kufiri zakonisht do të përcaktohet si përqindje e kapitalit të bankës. Për një bankë të vogël, kufiri mund të vendoset gjithashtu si përqindje e totalit të portofolit të kredisë së bankës për të parandaluar rrezikun e përqendrimit të tepruar të kreditimit të bankës. Kufizimet mbi ekspozimet e mëdha mund të zbusin rrezikun e përqendrimit dhe të reduktojnë rrezikun e palës tjetër dhe mundësinë e infektimit. Ato gjithashtu zvogëlojnë ndjeshmërinë e institucioneve financiare ndaj goditjeve të përgjithshme apo sektoriale. BQK-ja aktualisht imponon kufizime të mëdha ndaj ekspozimit të kredisë.

**Kufizimet e kredive ndaj palëve të ndërlidhura** është vënia e kufizimeve mbi sasinë apo përqindjen e kreditimit të një banke që mund të huazohet për palët që kanë një biznes apo marrëdhënie personale me bankën. Palët e ndërlidhura janë përcaktuar në Ligjin e Bankave të Kosovës. Kreditë për palët e ndërlidhura janë një zonë e rrezikshme për një bankë dhe për stabilitetin e sektorit bankar në tërësi. Kufizimi në kreditimin e tillë mund të forcohet duke i kërkuar bankës të zbresë kreditimin e tillë nga kapitali, që e mban për t'i përmbushur kërkesat e saj për kapital minimal.

**Kufizimet mbi ekspozimet e mëdha në burimet e financimit** është një instrument që imponon një limit në proporcionin e financimit të një banke që mund të vijë nga një burim i vetëm. Burimi mund të përkufizohet si një depozitues i vetëm, një klasë e vetme e depozituesve apo një treg i vetëm. Arsyeja për këtë instrument është se rreziqet e përqendrimit mund të lindin për një bankë nga të dyja anët e bilancit të saj.

**Kufizimet e ekspozimit ndaj valutës së huaj:** Ekspozimet e pambuluara të këmbimit valutor janë një zonë e rrezikshme për institucionet financiare. Imponimi i kufizimeve mbi madhësinë e pozicioneve të hapura që mund ta ketë një bankë në portofolin total të këmbimit valutor do të zvogëlojë sasinë e rrezikut në sistemin bankar. Kufijtë mund të imponohen edhe mbi pozicionet e hapura maksimale të lejuara në valuta të huaja individuale.

**Kufizimi mbi pagesat e dividendëve** është vënie e një kufiri mbi madhësinë e pagesave të dividendëve që një bankë mund ta bëjë, veçanërisht në qoftë se banka është duke u përballur me vështirësi financiare apo probleme të likuiditetit, ose banka apo vendi është në një situatë të krizës financiare. Në situata ekstreme limiti mund të vendoset në zero.

**Kufizimet në nivelet e shpërblimit dhe sistemet** mund të vendosen nëse ekzistojnë sisteme të shpërblimit të dizajnuara në mënyrë të papërshtatshme. BQK-ja do të monitorojë sistemet e shpërblimit të bankave, sidomos stimujt për marrje përsipër të rrezikut, që janë mishëruar në sisteme dhe në qoftë se konsiderohet e nevojshme do të vendosë kufij në elemente të caktuara të sistemeve të shpërblimit.

**Kërkesa shtesë mbi kapitalin e kërkuar (ang. Capital surcharge buffers)** për institucionet me rëndësi sistemike (IFRS) mund të futen në përdorim. Kërkesa shtesë mbi kapitalin e kërkuar do të kontribuojë në rritjen e aftësisë për të mbuluar humbjet, në uljen e mundësisë së ngjarjeve të stresit dhe në kufizimin e pasojave të tyre. Përveç kësaj, ai mund të korrigjojë përfitimet e nënkuptuara që i gëzojnë IFRS-të si rezultat i garancive qeveritare të nënkuptuara.

**Shpalosja e zgjeruar** do të mund të arrihej duke shqiptuar masa përmes të cilave u kërkohet bankave të shpalosin publikisht një gamë të gjerë të informacionit financiar në lidhje me veten e tyre, që mund të kontribuojë në elasticitetin e sektorit financiar në një numër mënyrash. Kjo i nxitë bankat që të përpiqen dhe të shmangin zhvillimin e problemeve, për të shmangur efektin negativ nga shpalosja e zhvillimeve negative. Kjo shton gjithashtu informacionin e disponueshëm për pjesëmarrësit në tregun financiar dhe komentuesit në mënyrë që ata nga ana e tyre mund të marrin vendime më të informuara.

**Kufizimet mbi financimin e jashtëm** përfshijnë vënien e kufizimeve në sasinë apo përqindjen e financimit që një bankë mund ta sigurojë jashtë Kosovës. Arsyeja është se burimet e jashtme të financimit kanë tendencë të jenë më të paqëndrueshme në situata krize sesa financimi i brendshëm. Ky burim financimi mund të ndikohet gjithashtu nga vendimet e autoriteteve të jashtme monetare në një situatë krize. Ky kufi mundet në disa rrethana të aplikohet për financimin nga banka amë për një filial në Kosovë.

**Kufizimi mbi financimin me shumicë nga tregu** përfshin vënien e kufizimeve në sasinë apo përqindjen e financimit që banka mund ta sigurojë nga tregjet financiare me shumicë. Kjo mund të aplikohet për financimin me shumicë të brendshëm dhe atë të jashtëm. Arsyetimi është se financimi me shumicë ka tendencë të jetë më i paqëndrueshëm se depozitat me pakicë në një situatë krize. Pasi që Kosova ka tregje financiare të kufizuara me shumicë për momentin, një kufi ka më shumë gjasa që të vendoset mbi burimet e jashtme të financimit me shumicë.

Së fundi, me vlerësimin periodik të objektivave të ndërmjetme të politikave me kalimin e kohës, objektivat mund të rishikohen duke marrë parasysh rreziqet shtesë të shfaqura për stabilitetin financiar. Në funksion të fitimit të përvojës në funksionimin e politikave të reja të makroprudencës, si dhe duke marrë parasysh ndonjë ndryshim specifik strukturor apo vendor, objektivat mund të përshtaten më tej për të përballuar kërcënimet e reja në zhvillim e sipër. Balanca midis objektivave mund të ndryshojë me hyrjen në fuqi të politikave dhe instrumenteve të makroprudencës, prandaj rishikimi në të ardhmen mund të jetë i nevojshëm.

Tabela 1. Lista e instrumenteve potenciale të makroprudencës dhe baza ligjore përkatëse

Objektivat e ndërmjetme dhe Instrumentet	Baza ligjore
Zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe të levës	
Rezervat minimale	Neni 12, Ligji për BQK-në
Kufijtë agregat të kreditimit	Neni 46, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Limitet e kreditimit për sektorët specifikë	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Shkalla e liferimit	Neni 16, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Kërkesat kundër-ciklike të kapitalit (KKK)	Neni 16, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Neni 15, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Raporti kredi - vlerë (RKV)	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Raportet kredi/të ardhurat e kredimarrësit (KA)	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Kapaku kredi depozitë (KD)	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjeve të tepruara të maturimit	
Limitet mbi mospërputhjet e maturimit	Neni 85, Ligji për Bankat , IMF dhe IFJB
Zvogëlimi dhe parandalimi i mungesës së likuiditetit	
Kërkesat rreth rezervës minimale	Neni 12, Ligji për BQK-në
Proporcionet e likuiditetit	Neni 19, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB
Mbështetja emergjente për likuiditet	Neni 14, Ligji për BQK-në
Kufizimi i direkt dhe indirekt i koncentrimit të ekspozimeve kreditore	
Kufizimet në ekspozimet e mëdha	Neni 46, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Kufizimet në kreditim për palët e ndërlidhura	Neni 47, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Kufizimet e ekspozimit të madh ndaj financimit	Neni 46, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Kufizimet e ekspozimit të valutës së huaj	Neni 50, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Kufizimi i ndikimit sistematik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral;	
Limitet në pagesat e dividendëve	Neni 58, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Limitet në nivelet dhe sistemet e shpërblimit	Neni 58, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Mbingarkesa e kapitalit për IFRS-të	Neni 58, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Forcimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës financiare	
Rritja e shpalosjes	Neni 56, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Limitet në financimin e jashtëm	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të
Limitet në financimin me shumicë nga tregu	Neni 85, Ligji për Bankat, IMF dhe IFJB-të

## Shtojca II - Indikatorët e makroprudencës të monitoruar nga BQK-ja ndërlidhur me objektivat e ndërmjetme

BQK-ja ka modelin për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike dhe kryen stres testet për t'i identifikuar rreziqet sistemike. BQK-ja monitoron rregullisht shpërndarjen e rrezikut me anë të këtyre dy mekanizmave dhe shpalos rezultatin e tyre në publikimet e rregullta (Raporti i Stabilitetit Financiar). Zhvillimi i rrezikut sistematik monitorohet me anë të një sërë treguesish që do të zgjerohen më tej me funksionalizimin e instrumenteve të makroprudencës. Lista e mëposhtme e treguesve të makroprudencës do të themelohet në kuadër të përmbushjes së objektivave individuale të ndërmjetme dhe identifikimit të burimeve të mundshme të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar dhe me qëllim të udhëheqjes së vendimeve në lidhje me futjen në përdorim, çaktivizimin dhe kalibrimin e instrumenteve të makroprudencës.

Tabela 2. Lista e indikatorëve të mundshëm të monitoruar nga BQK-ja ndërlidhur me objektivat e ndërmjetme.

Zvogëlimi dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kredive dhe levës
Rritja e kredive në raport me Bruto Produktit Vendor (BPV)
Boshllëku ndërmjet kredive dhe BPV-së
Rritja e kredive të sektorit jobankar
Pjesëmarrja e kredive për ekonomitë familjare në gjithsej kreditë
Rritja e kredive të ekonomive familjare
<ul style="list-style-type: none"> <li>Konsumatorët (Individuale)</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Hipotekat</li> </ul>
Pjesëmarrja e kredive për Korporatat në gjithsej kreditë
Rritja e kredive për Korporatat
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kredit për Prodhimi</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kredit për Bujqësia</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Kredit për Tregti</li> </ul>
Pjesëmarrja e mjeteve të këqija në gjithsej mjete
<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i kredisë me vlerën për kreditë e ekonomive familjare</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i kredisë me vlerën për kreditë e korporatave</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i kredisë me të hyrat për kreditë e ekonomive familjare</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i kredisë me të hyrat për kreditë e korporatave</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesëmarrja e mjeteve jo-performuese në gjithsej mjetet</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesëmarrja e kredive jo-performuese në kreditë e ekonomive familjare</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesëmarrja e kredive jo-performuese në kreditë hipotekare</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesëmarrja e kredive jo-performuese në kreditë për prodhim</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja e kredive jo-performuese në kreditë për bujqësi</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrja e kredive jo-performuese në kreditë për tregti</li> </ul>
Mbulimi i kërkesave jo-performuese nga dëmtimet (provizionet, ang. impairment)
Mjaftueshmëria e kapitalit
Kualiteti i kredive
Leva
Zvogëlimi dhe parandalimi i mospërputhjeve të tepruara
Raporti kredi - depozita
Pjesëmarrja e kredive të denominuara në valuta të huaja
Kufizimet e pozicioneve të hapura në valuta të huaja
Struktura e bilancit të gjendjes
Zvogëlimi dhe parandalimi i jo-likuiditetit
Mjetet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra
Mjetet likuide ndaj gjithsej mjeteve
Kufizimi i koncentrimave direkte dhe indirekte ndaj ekspozimeve
Ekspozimi ndaj rrezikut të shpërndarjes (ang. contagion)
Koncentrimi i ekspozimeve ndaj subjekteve individuale dhe rreziqeve individuale
Standardet e vlerësimit të lejimit të kredive (ang. underwriting)
Kufizimi i ndikimit sistematik të nxitjeve që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral
Kthimi në ekuitet (ROE)
Margjina neto e interesit
Normat e interesit të bankave
Raporti Mjete - BPV
HHI (Indeksi Herfindahl-Hirschman) bazuar në mjete
Fuqizimi i rezistencës së infrastrukturës financiare
Rezultatet e stres testit
Rezultatet e identifikimit të IFRS (institucionet financiare me rëndësi sistematike)
Të gjitha siç janë listuar më sipër



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)